

# 1. VLERËSIM I PËRGJITHSHËM I RREZIQEVE KRYESORE TË STABILITETIT FINANCIAR


## 1.1. HARTA E STABILITETIT FINANCIAR

(1) Në krahasim me fundin e vitit 2017, në fund të vitit 2018, harta e stabilitetit financiar<sup>9</sup> tregoi një rritje të lehtë të rreziqeve në mjedisin ekonomik të jashtëm, ndërsa rreziqet nga mjedisi i brendshëm, që lidhen me zhvillimet në sektorin real dhe në sektorin bankar, shfaqin rënie. Vlerat e treguesve sugjerojnë se ekspozimi ndaj rreziqeve që lidhen me zhvillimet në "ekonominë e brendshme", në sektorin e "qeverisë" dhe veprimtarinë e sektorit të "individëve", kanë qenë përgjithësisht në rënie, krahasuar me fundin e vitit të kaluar, ndërsa rreziku nga sektori i "bizneseve" ka rezultuar në rritje. Nga ana tjetër, treguesit e veprimtarisë bankare që lidhen me "kapitalizimin dhe përfitueshmërinë" dhe "strukturën e sektorit bankar" nuk kanë shfaqur ndryshime të rëndësishme në nivelin e agreguar të rrezikut, ndërsa rreziku lidhur me "likuiditetin dhe financimin" ka qenë përgjithësisht në rënie.

Më konkretisht, për fundin e vitit 2018, vërehet që:


- a. në mjedisin e përgjithshëm ekonomik:
  - I. rreziku i agreguar nga "ekonomia e brendshme" vlerësohet në nivelin "mesatar" dhe ka shënuar rënie krahasuar me një vit më parë, kryesisht si rezultat i rritjes së qëndrueshme të PBB-së dhe rënies së stokut të borxhit të jashtëm,
  - II. rreziku që vjen nga "mjedisi i jashtëm" vijon të klasifikohet si rrezik "mesatar", por në rritje të lehtë në krahasim me fundin e vitit 2017, ndikuar nga ngadalësimi i rritjes ekonomike të partnerëve tregtarë të Shqipërisë. Ky ngadalësim mund të çojë në rënie të kërkesës së ardhshme për eksporte, ndërkohë që rritja e mundshme e normave afatshkurtra të interesit në tregjet e parasë mund të sjellë rritje të kostove të jashtme të financimit;
- b. tek agjentët e ekonomisë reale:
  - I. rreziku nga "bizneset" vlerësohet "i moderuar" dhe në rritje gjatë periudhës, në kushtet e përkeqësimit të pritjeve afatshkurtra të bizneseve

<sup>9</sup> Harta e Stabilitetit Financiar tregon shpërndarjen e rrezikut tek faktorët që ndikojnë stabilitetin e sistemit financiar. Këta faktorë përfshijnë mjedisin ekonomik rrethues, të brendshëm e të jashtëm, sektorin bankar, si dhe agjentët e ekonomisë reale - qeverinë, bizneset dhe individët. Afrimi pranë "qendrës" së hartës korrespondon me ulje të rrezikut.



- dhe të indeksit të gjendjes së tyre financiare<sup>10</sup>,
- II. rreziku nga "individët" vlerësohet "i moderuar" dhe ka mbetur pothuajse i pandryshuar gjatë vitit 2018,
  - III. rreziku nga zhvillimet në sektorin e "qeverisë" vlerësohet "i ulët" dhe ka shënuar rënie të lehtë gjatë periudhës, si rezultat i rënies së madhësisë së borxhit të qeverisë në raport ndaj PBB-së. Rreziku i ardhur nga nëntreguesit e tjerë të kësaj kategorie ka qenë i pandryshuar ose në rënie;
- c. në veprimtarinë e sektorit bankar:
- I. niveli i rrezikut nga "kapitalizimi dhe përfitueshmëria" vlerësohet "mesatar" dhe nuk ka ndryshuar në krahasim me fundin e vitit të kaluar. Rritja e nivelit të kapitalizimit të sektorit dhe përmirësimi i cilësisë së kredisë kanë zbutur rrezikun nga rënia e të ardhurave të sektorit, duke e mbajtur të pandryshuar nivelin agregat të rrezikut nga kjo kategori,
  - II. rreziku nga "likuiditeti dhe financimi" vlerësohet "i moderuar" dhe në rënie të lehtë krahasuar me vitin e kaluar. Ky zhvillim ka reflektuar ngushtimin e hendekut midis aktiveve dhe pasiveve të bankave me afat deri në 3 muaj dhe një rënie të lehtë të treguesit të financimit nga jorezidentët,
  - III. rreziku që lidhet me "strukturën e sektorit bankar" vlerësohet "mesatar", dhe me një prirje të lehtë për rritje krahasuar me një vit më parë, kryesisht si rezultat i rritjes së përqendrimit në kredinë bankare për sektorin e biznesit.

Grafik 1. Harta e stabilitetit financiar



\* Rreziku vlerësohet: i ulët për notat 0-3 në hartë, mesatar për notat 4-5, i moderuar për notat 6-8 dhe i lartë për notat 9-10. Lëvizja drejt skajeve të hartës, larg qendrës, nënkupton rritje të rrezikut. Burimi: Banka e Shqipërisë.


Hapësira informuese 1.1 paraqet të gjithë përbërësit e kategorive të Hartës së Stabilitetit Financiar gjatë gjysmës së dytë të vitit 2018, vlerësimet me "notë" për nivelin e rrezikut për secilin përbërës dhe krahasimin me vlerësimin e një viti më parë.

<sup>10</sup> Indeksi i gjendjes financiare të bizneseve është një ndër nënindekset e llogaritura nga vrojtimi i besimit të bizneseve që kryhet nga Banka e Shqipërisë çdo tremujor. Në këtë metodologji, ky indeks ka zëvendësuar indeksin e volumit të prodhimit të publikuar nga INSTAT-i.




HAPËSIRË INFORMUESE 1.1. PËRBËRËSIT E HARTËS SË STABILITETIT FINANCIAR


Rreziku nga "ekonomia e brendshme" vlerësohet "mesatar", por në rënie krahasuar me një vit më parë, për shkak të rritjes së qëndrueshme të PBB-së ndaj pritjes afatgjatë të saj dhe rënies së madhësisë së borxhit të jashtëm. Nga ana tjetër, rritja e nevojës për financim të jashtëm në fund të vitit, ka kontribuar në rritjen e rrezikut nga kjo kategori.




Rreziku lidhur me sektorin e "individëve" vlerësohet në nivelin "i moderuar", dhe më një njërije shumë lehtë rënies, krahasuar me fundin e vitit të kaluar. Rënia e nivelit të regjistruar të papunësisë dhe përmirësimi i cilësisë së portofolit të individëve kanë sjellë rënie të rrezikut nga ky tregues, ndërkohë që përqëpsimi i pritshmërive të tyre ka kontribuar në rritje të rrezikut.




Rreziku nga sektori i "bizneseve" vlerësohet "i moderuar" dhe në rritje gjatë periudhës, duke reflektuar përqëpsimin e pritjeve dhe të gjendjes financiare të këtij sektori (Indeksi i gjendjes financiare).




Rreziku që vjen nga "qeveria" vlerësohet i "ulët" dhe ka shënuar një rënie të lehtë, krahasuar me një vit më parë, si rezultat i rënies së madhësisë së borxhit të qeverisë në raport me PBB-në, ndërkohë që rreziku nga nëntreguesit e tjerë të kësaj kategorie ka mbetur i pandryshuar.




Rreziku nga "mjedisi i jashtëm" vlerësohet në nivelin "mesatar" dhe në rritje, ndikuar nga ngadalësimi i rritjes ekonomike të partnerëve kryesorë tregtarë (kryesisht Italia dhe Gjermania), rritja e masatës së normave afatshkurtra (Euribor, Libor 3-mujore) në tregjet e parësë dhe sinjalit për rënie dhe cikël global të biznesit sipas indeksit "CLI".




Rreziku që vjen nga "financimi dhe likuiditeti" ka rezultuar në nivelin "i moderuar" dhe në rënie, si rrjedhojë e ngushtimit të hendekut midis aktiveve dhe pasiveve afatshkurtra deri në 3 muaj dhe rënies së financimit nga jorezidentët.



Niveli i rrezikut nga "kapitoli dhe përfuturshmëria" vlerësohet "mesatar" dhe i pandryshuar gjatë periudhës. Rritja e kapitalizimit të sektorit bankar dhe përmirësimi i cilësisë së kredive kanë sjellë rënie të rrezikut në këtë kategori, ndërkohë që rreziku i lidhur me të ardhurat e sektorit ka mbetur në nivele të larta dhe në rritje, si rezultat i rënies së vazhdueshme të të ardhurave (ndonëse prej niveleve të larta).



Rreziku nga "struktura e sektorit bankar" mbetet në nivelin "mesatar" dhe në rritje të lehtë gjatë periudhës, si rezultat i rritjes së devijimit të RMK-së së bankave ndaj masatës së sektorit dhe rritjes së përqendrimin të huadhënies për sektorin e biznesit, e matur nga treguesi i variancës së portofolit të kredive për biznesin.




\*Indeksi i gjendjes financiare – CLI (Composite Leading Indicator) - është një ndër indekset kryesore ndërkombëtare që sinjalizon pikat e kthimit në ciklin e biznesit, ose luhatjet e aktivitetit ekonomik rreth nivelit të prodhimit potencial afatgjatë dhe vlerësohet nga OECD-ja.

Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar, Banka e Shqipërisë.

## 1.2. RREZIKU SISTEMIK<sup>11</sup>

Vlerësimi i ekspozimit të sektorit bankar ndaj rrezikut sistemik kryhet duke analizuar ecurinë e treguesve që lidhen me: a) materializimin dhe me akumulimin e rrezikut sistemik; b) nivelin e stresit në sistemin financiar; dhe c) perceptimin e industrisë bankare mbi ekspozimin e veprimtarisë së saj ndaj rreziqeve sistematike. Indeksi i materializimit të rrezikut sistemik ofron një vlerësim lidhur me nivelin aktual të rrezikut, ndërsa indeksat e akumulimit të rrezikut, të stresit financiar dhe të perceptimit të industrisë bankare rreth tij, fokusohen kryesisht drejt së ardhmes.

Grafik 2. Indekset e akumulimit dhe materializimit të rrezikut sistemik




Burimi: Banka e Shqipërisë.

(2) **Materializimi i rrezikut sistemik ka shfaqur rënie gjatë periudhës dhe krahasuar me një vit më parë, ndërsa indeksi i akumulimit të rrezikut sistemik ka shënuar rënie në terma vjetorë.** Në ecurinë e indeksit të materializimit të rrezikut kanë ndikuar përmirësimi i cilësisë së kredisë për individët, rënia e nivelit të papunësisë në vend, si dhe zbutja e luhatjeve në ecurinë e kursit të këmbimit. Në rënie të indeksit të akumulimit të rrezikut sistemik ka ndikuar rënia e tepicës së kredive të pambrojtura nga kursi i këmbimit dhe zvogëlimi i borxhit të jashtëm dhe atij publik.

(3) **Indeksi i stresit financiar ka rezultuar në rënie,** ndikuar nga përmirësimi i ecurisë së disa prej treguesve të sektorit bankar (siç janë depozitat dhe marzhi neto i interesave) ndaj prirjes së tyre historike, ndërkohë që ecuria e treguesve të tregut të parasë dhe të kursit të këmbimit nuk ka sjellë ndryshime të rëndësishme në indeks.


Grafik 3. Indeksi i stresit financiar



Burimi: Banka e Shqipërisë.


(4) **Perceptimi i industrisë bankare mbi rreziqet sistematike ka treguar përgjithësisht rënie gjatë periudhës;** rreziku i "përkeqësimit të ekonomisë së brendshme" mbetet rreziku kryesor sistemik në vend, por perceptimi mbi nivelin e rëndësisë së tij vlerësohet "mesatar" dhe në rënie. Rritja e qëndrueshme e ekonomisë së vendit gjatë viteve të fundit, ka ndikuar në zbutjen e perceptimit të industrisë bankare mbi këtë rrezik. Perceptimi mbi rrezikun e lidhur me "ekzekutimin e kolateralëve" gjithashtu ka rezultuar në rënie gjatë dy vrojtimeve të fundit. Ndonëse procesi i ekzekutimit të kolateralëve vijon të konsiderohet i vështirë dhe i kushtueshëm për bankat, masat e

<sup>11</sup> Rreziku sistemik përcaktohet si "mundësia e materializimit të goditjeve që dëmtojnë funksionimin e sistemit financiar deri në masën që rritja ekonomike dhe mirëqenia të ndikohen në mënyrë materiale".



ndryshme ligjore, rregullative e administrative të marra gjatë viteve të fundit, në kuadër të strategjisë për trajtimin e kredive me probleme, mund të kenë dhënë rezultat në lehtësimin e këtij procesi.

(5) Gjatë periudhës vihet re një rritje e shqetësimit të bankave mbi “rrezikun politik në vend” dhe “rrezikun e kursit të këmbimit”. Zhvillimet politike gjatë fundit të vitit 2018, të cilat çuan në ndryshime të kabinetit qeveritar, dhe presionet për mbiçmimin e lekut në raport me euron, duket se janë reflektuar në rritjen e vëmendjes së bankave ndaj këtyre dy rreziqeve që ato i kanë evidentuar si rreziqe me natyrë sistemike.



## HAPËSIRË INFORMUESE 1.2: POLITIKA MAKROPRUDENCIALE

Politika makroprudenciale fokusohet tek parandalimi i rrezikut sistematik dhe rritja e rezistencës së sistemit financiar ndaj tij. Rreziku sistematik zhvillohet në dy dimensione, ciklik dhe strukturor.

Dimensioni ciklik i rrezikut sistematik lidhet me prirjen e institucioneve financiare për të rritur oreksin për rrezik në periudha të rritjes ekonomike, dhe për t’u shfaqur tepër të tërhequra në periudhat e rënies ekonomike. Asnjë prej këtyre sjelljeve nuk është e dëshiruar, ndaj përmes instrumenteve të saj, politika makroprudenciale synon ta zbusë këtë sjellje prociklike të sistemit financiar. Banka e Shqipërisë ka punuar për të vlerësuar prociklikalitetin e ciklit financiar me rritjen ekonomike (ecurinë e PBB-së).

Për këtë qëllim është ndërtuar fillimisht një indeks i ciklit financiar, i cili, mbështetur në literaturën përkatëse dhe strukturën e tregut financiar në vend, ndërlidh treguesit e kredisë me çmimet e asetëve. Këta të fundit, konsiderohen si variabla po aq të rëndësishëm të ciklit financiar, ndonëse literatura i shqyrton gjithmonë të ndërthurur me variablat e kredisë. Më konkretisht, indeksi i ciklit financiar për Shqipërinë përfshin:



- raportin e kredisë<sup>12</sup> ndaj PBB-së, si një variabël i rëndësishëm i analizave makroprudenciale;
- rritjen vjetore të kredisë, si një variabël që vlerëson shkallën e përsheptimit të zgjerimit të kredisë, e përshtatur për inflacionin;
- indeksin e çmimeve të banesave, si një variabël që kap zhvillimet e çmimeve të aktiveve jofinanciare, të përshtatura për inflacionin.


Një cikël financiar që zhvillohet shpejt, tenton të përmirësojë treguesit financiarë të institucioneve financiare, shoqërohet me rritjen e rrezikut dhe më tej me materializimin e tij. Për të vlerësuar këtë lidhje për Shqipërinë, si tregues i materializimit të rrezikut është konsideruar raporti i kredive me probleme. Nga grafiku mund të kuptohet qartësisht që rritja e ciklit financiar (rritja e indeksit)

në periudhën 2000-2007 është shoqëruar me ulje të raportit të kredive me probleme, ndërsa rënia e tij, ndikuar në këtë rast nga shpërthimi i krizës financiare globale në 2008, është shoqëruar me rritjen e kredive me probleme në periudhën 2008-2013.

Për të kapur më mirë ciklin financiar në funksion të stadiit të zhvillimit ekonomik të vendit, sugjerohet përdorimi i një treguesi tjetër, atij të hendekut të raportit “kredi ndaj PBB-së” (HND-K/PBB). Ky tregues evidenton diferencën midis vlerës aktuale të “kredi/PBB” me prirjen e tij afatgjatë. Kur kjo diferencë është e konsiderueshme, gjykohet nëse rritja/tkurraja e kredisë është ose jo e tepërt. Për vendin tonë, si tregues i kredisë për këtë rast është marrë “kredia për ekonominë”, e cila përfshin kredinë e dhënë për subjektet rezidente jofinanciare private nga bankat dhe institucionet financiare jobanka.


Hendeku i raportit “kredi/PBB” është një tregues i rëndësishëm për politikën makroprudenciale. Ai shërben si tregues parësor për zbatimin e shtesës kundërciklike të kapitalit. Kjo e fundit, duke u rritur për bankat gjatë fazës rritëse të ciklit dhe duke u lejuar të pakësohet gjatë fazës rënëse të tij, vepron si një mekanizëm që ul prociklikalitetin në veprimtarinë bankare, dhe zbut luhatjet e mëdha në ndërmjetësimin financiar. Standardet e Bordit Evropian të Rrezikut Sistemik sugjerojnë që treguesi i mësipërm të plotësohet/mbështetet edhe me tregues të tjerë, që mund të sinjalizojnë më shpejt zhvillimet e padëshiruara. Banka e Shqipërisë i ka përcaktuar dhe llogaritur këta tregues për vendin tonë. Në plotësim të treguesit të “hendekut të raportit kredi/PBB” është përdorur “Treguesi i Paralajmërimit të Hershëm Plotësues”, i cili përfshin edhe disa nëntregues të intensitetit të kredisë dhe të çmimeve të asetëve jofinanciare.

Grafik 5. Ecuria e treguesit të ciklit financiar (djathtas) dhe RKP-së (majtas)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6. Ecuria e treguesve kryesorë financiarë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

<sup>12</sup> Për kredinë, të dhënat mbështeten në kredinë bankare ndaj sektorit privat jofinanciar.



Prej ecurisë së këtyre treguesve, mund të konstatohet që:

- ata kapin në mënyrë të përshtatshme fazën aktuale të ciklit financiar, e cila është rënësë. Megjithatë, treguesit "HND - K/PBB" dhe të "TPHP" duket sikur sugjerojnë një ndalim të rënies;
- në kuadër të zbatimit të mundshëm të shtesës kundërciklike të kapitalit, ecuria e treguesit "HND-K/PBB" (thellësisht në territor negativ), nuk sugjeron nevojën e zbatimit të këtij instrumenti në të ardhmen e parashikueshme.

Krahas dimensionit ciklik, Banka e Shqipërisë ka punuar edhe në drejtim të vlerësimit të dimensionit strukturor të rrezikut sistemik. Ky dimension buron nga shtrirja e rrezikut sistemik në pjesët e sistemit financiar. Ai shfaqet në rastet kur institucionet financiare janë aq të mëdha ose aq të ndërlidhura saqë, nëse preken nga një zhvillim i pafavorshëm ekonomik ose financiar, lokal ose ndërkufitar, pasojat mund të kërcënojnë qëndrueshmërinë e të gjithë sistemit financiar. Në këtë drejtim, në qendër të përpjekjeve të Bankës së Shqipërisë ka qenë rishikimi i metodologjisë për përcaktimin e bankave me rëndësi sistematike, si dhe përcaktimi i mënyrës se si mund të zbatohet shtesa përkatëse e kapitalit për rëndësinë sistematike, si një instrument i politikës makroprudenciale.

Kështu, gjatë vitit 2018, është rishikuar mënyra e llogaritjes së notës së rëndësisë sistematike, e cila mbështetet në kuadrin metodologjik të Autoritetit Bankar Evropian dhe të Komitetit të Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare; është rishikuar kufiri minimal për përcaktimin e bankave me rëndësi sistematike për të reflektuar ndryshimet strukturale në sektorin bankar vendas; si edhe është përmirësuar teknika e llogaritjes së kërkesës për shtesë kapitali për secilën shportë/interval të notës së rëndësisë sistematike.

Në mënyrë që metodologjia të reflektojë sa më mirë veçoritë e sektorit bankar vendas dhe marrëdhëniet e këtij sektori me pjesët e tjera të sistemit financiar, disa nga kategoritë e notës së rëndësisë sistematike si "madhësia", "zëvendësueshmëria" dhe "kompleksiteti", kanë pësuar ndryshime të nëntreguesve përbërës dhe peshave përkatëse. Kështu, në kategorinë "zëvendësueshmëria" janë përfshirë tregues të lidhur me investimet e bankave në bursë, aktivet nën kujdestari dhe aktivet e fondeve të investimit dhe të pensioneve në të cilat bankat mund të jenë pjesëmarrëse. Në kategorinë "kompleksiteti" janë përfshirë treguesit e derivativave mbi banak (OTC) dhe të investimeve jolikuide. Pavarësisht se aplikimi i metodologjisë së rishikuar nuk ka sjellë ndryshime rrënjësore në notat përkatëse dhe në renditjen e bankave sipas rëndësisë, Banka e Shqipërisë vlerëson se kjo metodologji që ndërthur praktikën më të mira ndërkombëtare me përvojën dhe rezultatet empirike të analizave të Bankës së Shqipërisë, përfaqëson një instrument të rëndësishëm për vlerësimin, monitorimin dhe parandalimin e rritjes së rrezikut strukturor në të gjitha dimensionet kritike të tij.

Si pjesë e procesit për ndërtimin e kuadrit të shtesave makroprudenciale të kapitalit, metodologjitë e mësipërme janë publikuar prej disa muajsh në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë, për konsultim nga industria bankare dhe publiku i interesuar.

Në kuadër të zbatimit të politikës makroprudenciale, me qëllim zbutjen e rrezikut sistemik në dimensionin e tij strukturor, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë disa masa për fuqizimin e përdorimit të lekut në veprimtarinë bankare. Këto masa, hynë në fuqi të plotë gjatë periudhës (korrik 2018). Në përputhje me angazhimet e marra në memorandumin përkatës ndërinstitucional, Banka e Shqipërisë ka identifikuar disa tregues për të vlerësuar efektin e masave dhe



*nevojën për rishikimin/pasurimin e tyre. Bazuar në ecurinë e këtyre treguesve, gjatë gjashtëmujorit të dytë 2018, vërehet se lëvizjet në shumicën e tyre janë të vogla dhe, në tërësi, vlerat e treguesve mbeten të shmangura ndjeshëm nga vlerat mesatare të treguesve për vende me ekonomi të ngjashme si Shqipëria. Në këto kushte, është e parakohshme dhënia e një vlerësimi për ndikimin e këtyre masave dhe nevojitet rishikimi i rregullt i tyre.*

